



Nr. 921 / Prot.  
3

Tiranë, më 30.03.2022

**VENDIM**

Nr. 24, datë 30.03.2022

**“PËR TARI FAT E SHKOLLIMIT PËR PROGRAMET E CIKLIT TË PARË, TË INTEGRUAR TË CIKLIT TË DYTË DHE CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL” DHE “MASTER I SHKENCAVE” NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023”**

Në zbatim të nenit 3 (pika 3/ç), të neneve 47, 49 të ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 288, datë 21.05.2018 “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në Institucionet publike të Arsimit të Lartë në një program të ciklit të parë...” i ndryshuar; të nenit 49, 51 të Statutit të UMT-së; të Rregullores së UMT-së; të nenit 4 (pika 1/m) të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Bordit të Administrimit të UMT-së”; të Vendimit të Senati Akademik nr. 23, datë 17.03.2022 “Për tarifat e shkollimit për programet e ciklit të parë, të integruar të ciklit të dytë...”; Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 30.03.2022,

**VENDOSI:**


1. Të miratojë tarifat vjetore të shkollimit për studentët që regjistrohen në vitin e parë, në programet e studimeve të ciklit të parë, të integruar të ciklit të dytë dhe të ciklit të dytë të studimeve, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë për vitin akademik 2022-2023, sipas tabelave 1, 2 dhe 3 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi. Studenti i ciklit të parë dhe të integruar të ciklit të dytë të studimeve, i cilësuar në bazë të rregullores së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë si përsëritës i nënshtrohet tarifës vjetore të shkollimit të vitit akademik, në të cilin vazhdon studimet. Student përsëritës konsiderohet student i që nuk ka plotësuar numrin e nevojshëm të krediteve për të kaluar në vitin pasardhës.
3. Studentët e ciklit të dytë të studimeve “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave”, të cilët nuk e kanë përfunduar programin përkatës të studimit apo nuk kanë shlyer të gjitha provimet e parashikuara në atë program studimi, brenda kohëzgjatjes normale të tij, dhe konsiderohen studentë mbetës/përsëritës për lëndët përsëritëse, do të paguajnë çdo vit akademik tarifën për kredit për lëndët përsëritëse.

4. Studentët, që transferojnë studimet në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë i nënshtrohen tarifës vjetore të shkollimit të programit të studimit përkatës, në të cilin ata kanë kërkuar të transferojnë studimet.
5. Shtetasit e huaj, që vazhdojnë studimet në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, në një program të parë apo të dytë studimi, i nënshtrohen të njëjtës tarifë shkollimi, si shtetasit shqiptarë që vazhdojnë studimet në programet respektive, me përjashtim të rasteve kur me marrëveshje zyrtare janë vendosur mënyra të tjera të përcaktimit të tarifave të shkollimit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për zbatimin dhe publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit.

**KRYETAR  
ZAMIRA GJINI**




**ANËTARË  
VERA OSTRENI**



**MONIKA FIDA**



**ALTINA XHAFERI**



**ALBANA GJINOPULLI**

**ANIS THODHORJANI**

**ENDRIT YZEIRAJ**



**Tarifat e shkollimit për ciklin e parë të studimeve si dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, për vitin akademik 2022-2023.**

*Tabela 1*

Nr.	Fakulteti	Cikli i studimit	Emërtimi i programit të studimit	Tarifa vjetore për program të parë	Tarifa vjetore për program të dytë
1	Fakulteti i Mjekësisë	PICD	Mjekësi e Përgjithshme	45,000	
2	Fakulteti i Mjekësisë	PICD	Farmaci	45,000	233,916
3	Fakulteti i Mjekësisë Dentare	PICD	Stomatologji	45,000	
4	Fakulteti i Mjekësisë	Bsc	Shëndet Publik	40,000	
5	Fakulteti i Mjekësisë Dentare	Bsc	Teknikë Dentare	40,000	233,916
6	Fakulteti i Mjekësisë Dentare	Bsc	Higjenist Dentar	40,000	233,916
7	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Bsc	Infermieri e Përgjithshme	40,000	233,916
8	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Bsc	Mami	35,000	233,916
9	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Bsc	Fizioterapi	35,000	233,916
10	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Bsc	Teknikë Laboratori	35,000	233,916
11	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Bsc	Teknikë Imazherie	35,000	233,916
12	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Bsc	Logopedi	35,000	233,916

**Tarifat e shkollimit për ciklin e dytë të studimeve Master Profesional, me kohë të plotë, për vitin akademik 2022-2023.**

*Tabela 2*

Nr.	Fakulteti	Cikli i studimit	Emërtimi i programit të studimit	Tarifa vjetore për program të parë	Tarifë për kredit
1	Fakulteti i Mjekësisë	MP	Menaxhim Shëndetësor	72,000	1,200
2	Fakulteti i Mjekësisë	MP	Shëndet Publik	72,000	1,200
3	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	MP	Menaxhim Infermieror	72,000	1,200
4	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	MP	Mami	72,000	1,200
5	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	MP	Fizioterapi	72,000	1,200
6	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	MP	Teknikë Laboratori	72,000	1,200
7	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	MP	Teknikë Imazherie	72,000	1,200
8	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	MP	Logopedi	72,000	1,200
9	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	MP	Kujdes Paliativ	72,000	1,200
10	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	MP	Infermieri Familje	72,000	1,200

**Tarifat e shkollimit për ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave, me kohë të plotë, për vitin akademik 2022-2023.**

*Tabela 3*

Nr.	Fakulteti	Cikli i studimit	Emërtimi i programit të studimit	Tarifa vjetore për program të parë	Tarifë për kredit
1	Fakulteti i Mjekësisë	Msc	Shëndet Publik	105,000	1,750
2	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Msc	Infermieri	105,000	1,750
3	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Msc	Mami	105,000	1,750
4	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Msc	Fizioterapi	105,000	1,750
5	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Msc	Teknikë Laboratori	105,000	1,750
6	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Msc	Teknikë Imazherie	105,000	1,750
7	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Msc	Logopedi	105,000	1,750